



**VENDIM**  
**Nr. 88, Datë 07.06.2017**

**MBI**  
**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETVEVE TË**  
**SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K, NË FAVOR TË**  
**BANKAVE “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE**  
**S.A,(GGF)” DHE “OESTERREEICHISCHE ENTWICKLUNGBANK**  
**AG(OeEB)”**

Në mbështetje të neneve 16; 44 pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7 dhe 11 të “Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” miratuar Vendimin nr.99, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE, gjithashtu dhe neni 15 i “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k, për lënien peng të asetveve në favor të Bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A,(GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungbank AG(OeEB)”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Konstatoi se:**

ERE me Vendimin nr. 143, datë 15.08.2016, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “LENGARICA & ENERGY “ sh.p.k, për lënien peng të asetveve në favor të Bankave “**Green For Growth Fund Southeast Europe S.A,(GGF)”** dhe “**Oesterreeichische Entwicklungbank AG(OeEB)”**.

Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gërmat:

- “a“ ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar;
- “b“- veprimtaria e licensuar, është plotësuar;
- “c“ - gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve, është plotësuar;
- “d“-përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim asetit, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar;
- “e“- arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar;
- “f“-efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar;
- “g“-efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar;
- “h“ -marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja përmban një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen, është plotësuar;
- “i“- deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar;
- -“j”(Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është e pa plotësuar;

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY“ sh.p.k, për lënien peng të asetëve në favor të Bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A,(GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungbank AG(OeEB)”. ( lista bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Bordi



---

Votimi i Bordit të ERE-s për,  
**VENDIMIN**  
*Nr. 88, Datë 07.06.2017*

**MBI**  
**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË**  
**SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K, NË FAVOR TË**  
**BANKAVE “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE**  
**S.A,(GGF)” DHE “OESTERREEICHISCHE ENTWICKLUNGBANK**  
**AG(OeEB)”**

Anëtarët e Bordit

|                      | Pro   | Kundër |
|----------------------|-------|--------|
| <b>Petrit Ahmeti</b> | _____ | _____  |
| <b>Adriatik Bego</b> | _____ | _____  |
| <b>Abaz Aliko</b>    | _____ | _____  |
| <b>Entela Shehaj</b> | _____ | _____  |
| <b>Maksim Shuli</b>  | _____ | _____  |

***ASETETET TË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K, PËR  
LËNIEN PENG,NË FAVOR TË BANKAVE “GREEN FOR GROWTH  
FUND SOUTHEAST EUROPE S.A,(GGF)” DHE  
“OESTERREEICHISCHE ENTWICKLUNGBANK AG(OeEB)”***

- (I) një digë ujëmbledhës me gjërësi 100m x 20m trashësi prej betoni,duke përfshirë një portë dalëse dhe dy portat hyrëse.
- (II) një desandër, 1300m<sup>2</sup> total dhe gjatësi 96m, mure të izoluar me perimetër 220m, përfshirë edhe 6 porta hyrëse dhe 3 porta dalëse.
- (III) një kanal ujë mbledhës me një gjatësi 100m x 3,7m gjërësi x 3,1m thellësi , përfshirë aksesin në kanal prej 26 m.
- (IV) një túnel me gjatësi totale 4000 m dhe pamje mesatare 11 m<sup>2</sup>.
- (V) një pellg ballor prej betoni rreth 150m<sup>3</sup>, duke përfshirë një portë dalëse dhe një porë emergjente.
- (VI) një tubacion (GRP),me gjatësi 1220m, me diametër 2,4 m; tubacion me gjatësi 1250 m, me diametër 2,2 m dhe një tubacion me gjatësi 1200 m, me diametër 2 m.
- (VII) një godinë çentrali me sipërfaqe rreth 220 m<sup>2</sup>, duke përfshirë të gjitha paisjet elektrike dhe elektromekanike që përfshinë 2 turbina, 3 gjeneratorë, 2 valvola gji, një sistem që anashkalon me një valvol, kompartimentet e tensionit të lartë, tensionit të ulët dhe sistemin e kontrollit.
- (VIII) një kanal uji me rreth 981m gjatësi dhe 14 m gjërësi, bërë me beton.
- (IX) një lidhje në rrjet i përbërë nga 2 kabllot e energjisë, një transformator TM/TL 110 kV dhe një N/st komutimi (vendi dhe zona do të përcaktohen gjatë punimeve)